



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

Nr. 0002/1 prot.,

Vlorë, më 19.04.2024

PROJEKT- VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2024

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE, QË PËRFITOJNË SUBVENCIONIN E QIRASË NË TREG TË LIRË DHE VLERAT E SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR ÇDO RAST.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar neni 2 pika 34/a,b,c, pika 35, pika 36, pika 42, neni 33, neni 38, të VKM Nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, të VKM Nr.384 datë 12/06/2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituruar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të VKM Nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit, si edhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë;

**V E N D O S I**

- I. Të miratojë listën e familjeve dhe individëve, që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast, grupi i dytë i përfituesëve për vitin 2024 sipas tabelës bashkëlidhur.
- II. Efektet financiare sipas pikës 1 do të mbulohen nga buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2024
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, si edhe Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Vlorë
- IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.



KRYETAR

Ermal Dredha

## LISTA E FAMILJEVE / INDIVIDIVEDE QE PERFITOINE SUBVENCIONIN E QIRASE PER VITIN 2024

(Grupi i dytë)

Nr.	Emri	Aftësia	Mblenmri	Kategoria sipas nentit 16 të ligjit nr.22/2018	Përberja familjare	Struktura e ap. sipas normative të strehimit	Sipërfaqja e ap.m2 sipas kontratës qirasë	Qiraja mes.e apart. në treg për strukturën që l takon	Të ardhurat familjare mujore	Kategoria sipas pikës 45 të nentit 2 të ligjit 22/2018	Aftësia përball. e familjes	Qiraja e përball.	Subvencioni mujor	Subvencioni vjetor
1	Vibertina	Fetah	Myftaraj	Fam.njëpr. PAK. Kom.egj	3 1+1	38,73		Nd.ek.	Pa të ardh.	0%	0	10000	120000	
2	Nysret	Birçe	Çinaj	PAK	3 1+1	50		Nd.ek.	Pa të ardh.	0%	0	8000	96000	
3	Sadete	Zenel	Daja	PAK	4 2+1	86		Nd.ek.	Pa të ardh.	0%	0	15000	180000	
4	Zelila	Shaip	Dule	e moshuar e vetmuar	1 garsonierë			pens.21869	Ashu	15%	3280	6720	80640	
5	Adrian	Dhimitri	Velo	1PAK	4 2+1	75,50		12000	Ashu	15%	1800	16200	194400	
6	Ilir	Vasil	Mataj	PAK, fam. kom. egj.	2 garsonierë			PAK	Pa të ardh.	0%	0	10000	120000	
7	Viola	Maliq	Runa	e moshuar e vetmuar	1 Garsonierë			pens. 9327	Ashu	15%	1399	8601	103212	

894252



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË**  
**DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE**

**RELACION**

Për projekt-vendimin

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE, QË PËRFITOJNË SUBVENCIONIN E QIRASË NË TREG TË LIRË DHE VLERAT E SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR ÇDO RAST.**

Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr. 12, datë 26.02.2024 është miratuar lista e familjeve dhe individëve që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë për vitin 2024, grupi i parë i përfituesëve me 16 emra.

Në vazhdim kanë paraqitur kërkesat familje dhe individë të tjerë që jetojnë me qira në tregun e lirë dhe për shkak të kushteve familjare, ekonomike dhe sociale nuk mundet të përballojnë pagesat e qirasë të banesës kundrejt palës qiradhënëse.

Në zbatim të ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, të VKM Nr.362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, të VKM Nr.384 datë 12/06/2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” janë kryer të gjitha procedurat si vijon;

-të aplikimit dhe dokumentacionit pranë Bashkisë Vlorë nga qytetarët,

-të vlerësimit dhe verifikimit në terren nga struktura përgjegjëse për strehimin në bashkëpunim me njësitë administrative ku banojnë kërkuarit,

-të shqyrtimit të kërkesave dhe kualifikimit të tyre nga komisioni i strehimit të Bashkisë Vlorë,

-të vlerësimit të qirasë së përballueshme, të subvencionit mujor dhe vjetor që përfitojnë personat që kualifikohen nga Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë,

-të përgatitjes së Projekt-Vendimit dhe të përcjelljes për të miratuar në Këshillin e Bashkisë Vlorë nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike.

Familjet dhe individët që janë pjesë e këtij projekti përfaqësojnë:

1. Familje njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, me individ PAK, familje anëtare e komunitetit egjiptian, përfituese e ndihmës ekonomike, Vibertina Myftaraj
2. Familje me individë PAK, përfituese e ndihmës ekonomike, Nysret Çinaj
3. Familje përfituese e ndihmës ekonomike, kryefamiljari me sëmundje kronike, i paaftë për punë, Sadete Daja
4. E moshuar në pension që jeton vetëm, Zeliha Dule
5. Familje e përbërë nga 4 persona, ku kryefamiljari kryen punë të rastit, bashkëshortja person PAK, përfituese e KAMCP, Adrian Velo
6. Familje, ku kryefamiljari është individ PAK, përfitues i KAMCP, anëtar i komunitetit egjiptian, Ilir Mataj
7. E moshuar në pension që jeton vetëm, të ardhurat mujore përbëhen nga pensioni prej 9327 lekë, Violeta Runa.

Projekt-vendimit i bashkëlidhet tabela me listën emërore të familjeve në pritje të miratimit për të përfituar subvencionin e qirasë, e plotësuar me të dhënat e detajuara;

-për kushtet familjare, ekonomike, sociale,

- të dhënat e nxjerra nga kontratat e qirasë të nënshkruara me palën qiradhënëse për strukturën e apartamentit ku banojnë, sipërfaqet e banimit, masën e qirasë sipas kontratës,

-të ardhurat që përcaktojnë aftësinë përballuese të familjes,

- qiraja e përballueshme,

-subvencionin mujor dhe subvencionin vjetor për vitin 2024.

Sa më lart, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë projekt-vendimin e paraqitur për të ndihmuar me pagesat e qirasë familjet në nevojë që kërkojnë mbështetje nga Bashkia Vlorë.

**KRYETAR**

**Ermal Dredha**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 6002 prot.,

Vlorë, më 19 . 04 .2024

MIRATOHET  
KRYETAR

Ermal Dredha

VENDIM

Nr. 2, datë 16.04.2024

Në zbatim të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” të ndryshuar, neni 2 pika 34/a,b,c, pika 35, pika 36, pika 42, neni 33, neni 38, të VKM Nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësisve të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë, i mbledhur sot në datën 16.04.2024, pasi mori në shqyrtim kërkesat e qytetarëve bashkë me dokumentacionin përkatës për të përfituar nga projekti i subvencionimit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2024;

KONSTATOI SE

Deri në datën e sotme 16.04.2024 kanë paraqitur kërkesat 7 familje dhe individë të pastrehë, që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë mundësi ekonomike për të përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë. Bashkë me pamundësinë ekonomike këto familje paraqesin një sërë problematikash familjare dhe sociale. Të gjitha rastet janë aplikues dhe përfitues të subvencionit të qirasë prej vitesh. Kontratat e qirasë janë në vazhdim edhe për vitin 2024 dhe të verifikuara në fakt që në vitin e parë të aplikimit nga struktura përgjegjëse për strehimin së bashku me rajonet ku ndodhen këto banesa.

Sa më lart komisioni

VENDOSI

1. Të shqyrtojë kërkesat dhe dokumentacionin e 7 familjeve/individëve, që janë regjistruar pranë Bashkisë Vlorë për të përfituar subvencionin e qirasë në treg të lirë për vitin 2024.
2. Nëse do të do të regjistrohen pranë Bashkisë Vlorë kërkesa të reja për të përfituar subvencionin e qirasë për gjatë këtij viti, ato do të shqyrtohen dhe do të paraqiten për të miratuar në muajt e ardhshëm, në varësi të përputhshmërisë me përcaktimet në aktet ligjore e nënligjore.

3. Të përcaktojë masën e subvencionit të qirasë që përfiton çdo aplikant, në muaj dhe vit.

4. Të miratojë dhënien e subvencionit të qirasë dhe vlerat përkatëse për 7 familje dhe individë sipas tabelës së mëposhtme, që do të mbulohen nga buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2024.

Nr	Emër /Atësia/ Mbiemër	Të ardhurat mujore (lekë)	Qiraja mesatare në treg të lirë	Subvencioni lekë/muaj	Subvencioni vjetor lekë/vit
1.	Vibertina Fetah Myftaraj	Ndihmë ekonomike	10000	10000	120000
2.	Nysret Birçe Çinaj	Ndihmë ekonomike	8000	8000	96000
3	Sadete Zenel Daja	Ndihmë ekonomike	15000	15000	180000
4	Zeliha Shaip Dule	Pension =21869	10000	6720	80640
5	Adrian Dhimitri Velo	Kamcp +12000 pun.rastit	18000	16200	194400
6	Ilir Vasil Mataj	KAMCP	10000	10000	120000
7	Violeta Maliq Runa	Pension =9327	10000	8601	103212

5. Me përfundimet e mësipërme të përgatitet projekt vendimi që do të paraqitet për miratim në Këshillin e Bashkisë.

#### KOMISIONI

1. Irena Toshkallari
2. Zambak Selmani
3. Dorian Demiri
4. Ali Çakërri
5. Orest Ruçaj
6. Manuela Prifti
7. Donald Leskaj

8. Brisilda Çobaj
9. Kanan Shakaj
10. Genard Fegaj
11. Selim Haskoçelaj
12. Birçe Aliraj
13. Drita Mustafai